



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 1779/ Prot.

Koplik, më 12 / 12 / 2025

V E N D I M

Nr. 45, datë 11.12.2025

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës Financiare për familjen e Zotit Sulejman Beqir Bercaj banesa e te cilit është djegur nga zjarri

Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe ne mbledhje e datës 11.12.2025 me propozim të kryetarit të Bashkisë, mbështetur ne Ligjin 139/2015“Per vetëqeverisjen vendore“, neni 54, shkronja“dh“,Ligjin 45 neni 30,41 pika 1,2,3, datë18.07.2019“Per Emërgjencat Civile“, VKM_së nr.329 date 16.05.2012 kreu III/I “Per kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“,Udhëzimi i perbashkët i Ministrisë së Brendëshme dhe Ministrsë së Financave Nr.263,datë 224.05.2013 „Për kriteret dhe procedurat dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, VKB Nr.81..date 31.12.2024 Per miratimin e buxhetit të Vitit 2025.

V E N D O S I:

1-Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe per ndihmen e menjëherëshme financiare familjes së z. **Sulejman Beqir Bercaj**_në vlerën 500.000(pesëqindmijë) lekë, për djegjen e banesës së tij nga zjarri.

2-Burimi i financimit të jetë fondi i Emergjencave Civile parashikuar në Programin“**Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile**“, në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhë për vitin 2025 të miratuar me VKB. .81..datë 31.12.2024 në programin_“Perballimi i ndihmave të menjëhershne për familjet në raste fatkeqesie“.

3-Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjorë të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për familjen e z. **Sulejman Beqir Bercaj**_në vlerën e demit nga ana ndertimore ne shumen 1.540.614(një milion e pesëqind e dyzet mijë e gjashtëqindë e katërmëdhjetë.) lekë, 50% i saj eshte770.307 (shtatëqind e shtatëdhjetë e mijë e treqindë e shtatë.) lekë,si dhe vlere e demit ne paisje eshte 301.800(treqind e një mijë e tetëqind.) leke ku 50% i saj eshte 150.900(njëqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë. Sipas preventivave te Komisionit te Vlerësimit të dëmeve prane Bashkisë

Malësi e Madhe. Vlera totale e dëmëve është **1.842.414** (Një milion e tetëqind e dyzet e dy mijë e katërqindë e katërmbëdhjetë.) lekë ku 50% i saj është **921.207**(nëntëqind e njëzet e një mijë e dyqindë e shtatë) lekë.

4- Ngarkohet administrata e bashkisë Malësi e Madhe për likuidimin e shumes prej **500.000**(peseqindë mijë) lekë.

5. Pjesa tjetër e vlers do të planifikohet për likojdim në buxhetin e vitit 2026 është 421,207 (katerqind e njëzet e një mijë e dyqind e shtatë lekë) si pasojë e fondeve të pa mjaftueshme për kompensim

6. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Finances dhe sektori i Emergjencave Civile.

7. Ky vendim hyne në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit Nr.139/2015 „ Per

veteqeverisjen vendore“

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmuaj

Miratuar me 11.12.2025

Vota Pro 19

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me date 12.12.2025

